

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Barazia para Ligjit

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Constitutional Paragraph: 24 para 1

Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Neni 1

KEFDG
Konventa për
Eliminimin e të gjitha
Formave të
Diskriminimit ndaj
Gruas

Për qëllimet e kësaj Konvente shprehja "diskriminimi ndaj grave" nuk kupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bërhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër

Neni 1.1

KNEFDR
Konventa
ndërkombëtare mbi
eliminimin e të gjitha
formave të
diskriminimit racor

Çfarëdo dallimi, mospërfshirje, kufizim ose anësi e bazuar mbi racën, ngjyrën, prejardhjen ose përkatësinë etnike ose kombëtare e cila ka për qëllim shfuqizimin ose efektin e keqësimit të njohjes, kënaqësisë ose ushtrimit, në një drejtëpeshë të barabartë të të drejtave njerëzore dhe lirive fundamentale në sferën politike, ekonomike, sociale kulturore ose në çfarëdo sferë tjetër të jetës publike .

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 2.1

1. Shtetet palë d?nojn? diskriminimin racial dhe zotohen të ndjekin me të gjitha mjetet e p?rshtatshme dhe pa vonesë, një politik? të zhdukjes s? çdo forme të diskriminimit racial dhe t? ndihmojn? mir?kuptimin midis të gjitha racave. Për këtë qëllim:

(a) Çdo shtet palë zotohet se nuk do t? kryej? asnj? veprim apo praktikë të diskriminimit racial kundër personave, grupeve personash apo institucionesh dhe se do t? siguroj? që të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, t'i përmbahen këtij detyrimi;

(b) Çdo shtet palë zotohet se nuk do t? inkurajoj?, mbroj? apo mb?shtesë diskriminimin racial që zbatohet nga çfarëdo personi apo organizate;

(c) Çdo shtet palë duhet të marrë masa efektive për të rishikuar politik?n qeveritare, kombëtare ose lokale, si dhe për të ndryshuar, shfuqizuar ose anuluar çdo ligj dhe çdo dispozitë që kanë për q?llim krijimin e diskriminimit racial apo p?rjet?simin e tij atje ku ekziston;

(ç) Çdo shtet palë duhet q?, me të gjitha mjetet e p?rshtatshme, duke p?rfshir?, kur e kërkojnë rrethanat, edhe legjislationin, të ndaloj? diskriminimin racial që zbatohet nga çfar?do personi, grupi personash apo organizate dhe t'i japë fund atij;

(d) Çdo shtet palë zotohet se do të përkrahë, në rast nevoje, organizatat dhe l?vizjet integracioniste shum?racore, dhe mjetet e tjera për t'i zhdukur barrierat midis racave, dhe p?r t? shkurajuar çdo gj? që synon forcimin e p?rçarjes raciale.

Neni 6

**KNEFDR
Konventa
ndërkombëtare mbi
eliminimin e të gjitha
formave të
diskriminimit racor**

Shtetet palë do t'i sigurojn? çdo personi që ndodhet n?n juridiksionin e tyre mbrojtje dhe mjete juridike efektive n?p?rmjet gjykatave komb?tare dhe institucioneve të tjera shtet?rore kund?r çdo veprimi të diskriminimit racial, i cili, në kund?rshtim me këtë Konvent?, do të shkelte të drejtat dhe lirit? themelore si dhe të drejtën e k?rkimit nga gjykatat e tilla d?mshp?rblim adekuat dhe satisfaksion për çdo d?m që do t'i shkaktohej si rezultata i një diskriminimi të tillë.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

KNEFDR
Konventa
ndërkombëtare mbi
eliminimin e të gjitha
formave të
diskriminimit racor

Neni 2.2

2. Shtetet palë, po qe se e kërkojnë rrethanat, do t' marrin masa t' posaçme dhe konkrete në fushën sociale, ekonomike, kulturore dhe në fusha t' tjera, për të siguruar zhvillimin dhe mbrojtjen adekuate t' disa grupeve racore apo individëve që bëjnë pjesë në këto grupe me qëllim që t'u garantojnë atyre gëzimin e plotë dhe t' barabartë të të drejtave dhe të lirive themelore t' njeriut. Këto masa kurrsesi nuk duhet t' kenë për pasojë ruajtjen e të drejtave të pabarabarta apo t' veçanta për grupet e ndryshme racore pasi të jenë arritur objektivat që ato i kanë synuar.

KNEFDR
Konventa
ndërkombëtare mbi
eliminimin e të gjitha
formave të
diskriminimit racor

Neni 5 (V)

Në përputhje me detyrimet themelore të parashtruara në nenin 2 të kësaj Konvente, shtetet palë zotohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave:

(v) E drejta e arsimit dhe përparimit profesional;

PNDCP
Pakti Nderkombëtar për
të Drejtat civile dhe
Politike

Neni 26

Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtet tjetër.

KEDNJ
Konventa Evropiane
për Mbrojtjen e të
Drejtave dhe Lirive
Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

NENI 14

Ndalimi i diskriminimit Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër

Neni 7.

DUDNJ
Deklarata Universale
për të Drejtat e Njeriut

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që çënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

DUDNJ
Deklarata Universale
për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 2.1

KDF
Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

1. Shtetet palë respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë çdo fëmijë, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë,

Neni 2.2

KDF
Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

2. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij

Neni 12

Njohje e barabartë përpara ligjit

1. Shtetet Palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën e njohjes kudo si persona përpara ligjit.

2. Shtetet Palë pranojnë që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë kapacitetin Në varësi të dispozitave të këtij neni, Shtetet Palë do të marrin të gjitha masat e duhura dhe efektive për të siguruar të drejtën e barabartë të personave ligjorë njësoj si pjesa tjetër e popullsisë në të gjitha aspektet e jetës.

KDPAKPO
Konventa për të Drejtat
e Personave me Aftësi
të Kufizuar dhe
Protokolli Opsional

3. Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar personave me aftësi të kufizuar akses në lidhje me mbështetje që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e kapacitetit të tyre ligjor.

4. Shtetet Palë në përputhje me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut do të sigurohen që të gjitha masat që lidhen me ushtrimin e kapacitetit ligjor përmbajnë standarde të përshtatshme dhe efikase për të parandaluar abuzimin, këto standarde do të bëjnë të mundur që masat që lidhen me ushtrimin e kapacitetit ligjor respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit nuk kanë konflikt interesi dhe ndikim të panevojshëm, janë në propocion dhe të përshtatura sipas rrethanave të personit, aplikohen për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe u nënshtrohen shqyrtimeve të rregullta nga një autoriteti kompetent, i pavarur dhe i paanshëm apo një trupe gjyqësore. standardet do të jenë propocionale më masën që këto masa çënojnë të drejtat dhe interesat e personit me aftësi të kufizuar për të patur në pronësi apo për të trashëguar prona, për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe për të pasur akses të barabartë në kreditë bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredive financiare dhe do të sigurohet që personave me aftësi të kufizuar nuk iu hiqet në mënyrë arbitrare prona.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 1

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:

KEMTQNJ

Konventa e Këshillit të Evropës masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore

a) parandalimi dhe lufta e trafikimit të qenieve njerëzore, duke garantuar barazinë gjinore;

b) mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit, ndërtimi i një kuadri

gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazinë gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive; [...]

Neni 3

KEMTQNJ

Konventa e Këshillit të Evropës masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht pasjen e masave për të mbrojtur dhe nxitur të drejtat e viktimave, do të sigurohet pa diskriminuar për arsye të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, bindjet politike ose të tjera, origjina kombëtare apo sociale, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose një status tjetër.

Neni 2

KKEMFSHSAS

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual Lanzarote, 25. X. 2007

Parimi i mosdiskriminimit Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, në veçanti gëzimi i masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, do të sigurohet pa diskriminim mbi çfarëdo baze të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik ose ndonjë opinion tjetër, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me një pakicë kombëtare, me pronën, lindjen, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, paaftësinë ose staturë të tjera.

KEPLDHGF

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje

Neni 4.1

Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për çdokënd, veçanërisht gratë, për të jetuar pa dhunë në sferën publike, si dhe në atë private.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Article 4.2

KEPLDHGF

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje

2 Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe marrin pa vonesë masat legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t'i parandaluar, veçanërisht me anë të:

– shprehjes së parimit të barazisë midis burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke garantuar realizimin praktik të këtij parimi;

– ndalimit të diskriminimit kundër grave, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të sanksioneve, sipas rastit; – shfuqizimit të ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë gratë.

Neni 4.3

KEPLDHGF

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje

3 Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

KEPLDHGF

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje

Neni 4.4

4 Masat e veçanta që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna gjinore nuk konsiderohen diskriminim sipas kushteve të kësaj Konvente

Ligjet

Nenet

Neni 1

LKD

Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.

Llojet e trajtimit të pabarabartë

1. Llojet e trajtimit të pabarabartë janë si në vijim:

1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji;

1.2. Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme;

1.3. Ngacmimi konsiderohet diskriminim, kur një sjellje e padëshirueshme (që përfshin por, nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes) mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji;

1.4. Nxitja për të diskriminuar konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje”.

1.5. Viktimizimi konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe ndodhë kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit;

1.6. Segragacioni konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, duke përfshirë mbrojtjen e çdo personi që nuk merr pjesë në një ankim për diskriminim po që i cili mendohet ta ketë bërë ate, i cili ndodhë në rastet kur një ose disa persona veçohen nga të tjerët përmes personave fizik, juridik, ose me kombinimin e të dyjave, nga sektori publik, privat apo nga të dy sektorët, dhe ky veçim bëhet mbi një nga bazat e përcaktuara në nenin 1 (një) të këtij Ligji;

1.7. Diskriminimi në bazë të asociimit - konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, shënjestrimi i personave që nuk i përkasin një grupi të caktuar por, që janë palë të treta që asociohen me ato grupe;

1.8. Mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike

Ligjet

LKD

Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi

LKD

Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi

LKD

Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi

KPK

Kodi Penal i Republikës së Kosovës 06/l-074 - 2019

Nenet

Neni 3

Koncepti i diskriminimit

1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Format e rënda të diskriminimit

Sjellja diskriminuese e cila është motivuar nga më shumë se një bazë apo e cila është kryer më shumë se një herë, apo e cila ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore apo ka pasur pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën konsiderohet formë e rëndë e diskriminimit.

Neni 4.1.2

1.2. Diskriminimi i tërthortë konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerët, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme;

Neni 190.1

1. Kushdo që për shkak të përkatësisë kombëtare apo etnike, racës, fesë, apo për shkak që nuk i përket ndonjërisë përkatësi, apo për shkak të bindjeve politike ose bindjeve të tjera, gjinisë, invaliditetit, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, arsimit, pozitës shoqërore, prejardhjes sociale, gjendjes materiale, apo ndonjë karakteristike tjetër personale, tjetrit ia mohon ose kufizon të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë, ligj ose dispozita të tjera, akte të tjera të përgjithshme ose marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, apo i jep privilegje apo favore bazuar në këto dallime, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Ligjet

LSHSF

Ligji nr. 02/1-17 për shërbime sociale dhe familjare

LSH

Ligji nr. 04/1-125 për shëndetësi

LSH

Ligji nr. 04/1-125 për shëndetësi

LSH

Ligji nr. 04/1-125 për shëndetësi

LSH

Ligji nr. 04/1-125 për shëndetësi

LSH

Ligji nr. 04/1-125 për shëndetësi

Nenet

Neni 1.2

Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjisllacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t'u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale

Neni 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë në kujdesin shëndetësor 1. Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Neni 5.1.1

Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u udhëhequr nga parimet themelore

1.1. Barazia

Neni 5. 1.2

Gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës.

Neni 8. 1.

Ministria, përpilon politika dhe zbaton ligjet e një sistemi jo-diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore

Neni 9.1.1.

Zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe ligjeve që sigurojnë sistem jo diskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor;

Ligjet

LSH

Ligji nr. 04/1-125 për shëndetësi

Nenet

Neni 4. 2.

Të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor

Neni 5.1

Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

LP

Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Neni 5.2

2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.

LP

Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Neni 5.3

3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkritazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

LP

Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Neni 5.4

4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj.

LP

Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Neni 5.5

5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.

LP

Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Ndalimi i diskriminimit gjinor në marrëdhëniet e punës

1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, statusit martesor apo familjar, shtatzënisë, lindjes, prindërisë dhe secilës formë të kujdestarisë në sektorin publik ose privat, sa i përket:

1.1. kushteve për qasje në punësim, në punë të pavarur ose të obliguar, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, pavarësisht degës së aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, duke përfshirë avancimin;

1.2. qasjes në të gjitha llojet dhe nivelet e drejtimit profesional, trajnimin profesional dhe të avancuar dhe rikualifikimet përfshirë përvojën e punës praktike;

1.3. punësimi dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna, si dhe paga;

1.4. anëtarësimi dhe përfshirja në një organizatë të punëtorëve ose të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga organizatat e tilla;

1.5. Qasjes në punësim, përfshirë trajnimin për punësim, një trajtim i ndryshëm i cili është i bazuar në një karakteristikë lidhur me gjininë nuk paraqet diskriminim kur, për shkak të natyrës së veçantë të aktiviteteve profesionale apo të kushteve në të cilin kryhen ato, nëse një karakteristikë e tillë përbën një kërkesë përcaktuese profesionale, me kusht që qëllimi i saj është legjitim dhe kërkesa është proporcionale.

Neni 16 Ndalimi i diskriminimit gjinor në skemat e sigurimit shoqëror në punë

1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë në të gjitha skemat e sigurimit shoqëror në punë, në veçanti sa i përket:

1.1. fushës së skemave të tilla dhe kushtet e qasjes në to;

1.2. detyrimit për të kontribuar dhe llogaritjet e kontributeve;

1.3. llogaritjes së përfitimeve, përfshirë përfitimet suplementare në lidhje me bashkëshortin/ en apo vartësve, si dhe kushtet që rregullojnë kohëzgjatjen dhe gëzimin e të drejtës për përfitime.

Ligjet

LBGJ

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -
020 -2015

LBGJ

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -
020 -2015

Nenet

Neni 1

1. Ky ligj, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
2. Ky ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Neni 4

Ndalimi i diskriminimit gjinor

1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë gjinor, duke përfshirë trajtimin më pak të favorshëm të femrave për shkak të shtatzënisë dhe amësisë, gjendjes martesore, kombësisë, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar dhe besimit, moshës, ose ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligj apo marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare në fuqi.
2. Dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta dhe është e ndaluar.
3. Ngacmimi dhe ngacmimi seksual janë të ndaluara. Refuzimi apo dorëzimi i një personi ndaj sjelljes së tillë nuk mund të përdoret si bazë për një vendim që prek atë person.
4. Me qëllim të ndalimit të diskriminimit gjinor me legjislacion, politika, programe dhe praktika, parimi i barazisë gjinore dhe integritetit gjinor, duke përfshirë përfitimet pas shtatzënisë dhe lindjes, zbatohet në të gjitha planifikimet, buxhetimet dhe zbatimet e akteve të mësipërme nga subjektet publike dhe private.
5. Udhëzimi për diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë konsiderohet diskriminim sipas kuptimit të këtij ligji.
6. Nuk do të ketë viktimizim të personave të përfshirë në parashtrimin apo procedimin e ankesave të diskriminimit, ngacmimit apo ngacmimit seksual të parashtruara në bazë të këtij ligji.

Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore

1. Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjëse për të zbatuar masat legjislativë dhe masat tjera duke përfshirë: 1.1. analizën e statusit të femrave dhe meshkujve në organizatat dhe fushat përkatëse;

1.2. miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për barazi gjinore;

1.3. përfshirjen e integritit gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion;

1.4. sigurimin e proceseve të përzgjedhjes, punësimit dhe caktimit në punë, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese, në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të femrave dhe meshkujve;

1.5. përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve;

1.6. sigurimin e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit;

1.7. caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte, dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e femrave;

1.8. ndarjen sipas gjinisë të të gjitha të dhënave të nevojshme statistikore, që mblidhen, regjistrohen, përpunohen dhe obligohen që këto të dhëna t'i dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;

1.9. të marrë parasysh barazinë gjinore në rastin e emërimit të institucioneve, shkollave e rrugëve.

2. Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji shfuqizohet.

3. Kontratat publike si dhe çdo dispozitë në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, e cila është e përfshirë në kontratat apo marrëveshjet individuale a kolektive, janë ose mund të shpallen të pavlefshme apo të ndryshohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.

Ligjet

LBGJ

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -
020 -2015

Nenet

Neni 16

1. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë në të gjitha skemat e sigurimit shoqëror në punë, në veçanti sa i përket:

1.1. fushës së skemave të tilla dhe kushtet e qasjes në to;

1.2. detyrimit për të kontribuar dhe llogaritjet e kontributeve;

1.3. llogaritjes së përfitimeve, përfshirë përfitimet suplementare në lidhje me bashkëshortin/ en apo vartësve, si dhe kushtet që rregullojnë kohëzgjatjen dhe gëzimin e të drejtës për përfitime.

Detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës

1. Punëdhënësi/sja në të gjithë sektorët obligohet:

1.1. të shmang përfshirjen e elementeve diskriminuese në bazë të gjinisë në shpalljen e vendit të lirë të punës;

1.2. të promovojë barazinë gjinore para dhe gjatë marrëdhënies së punës;

1.3. të sigurojë mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt që aplikojnë për vende të lira të punës;

1.4. Kur për një vend të lirë pune ose për një kategori të caktuar pune nuk ka barazi gjinore, nuk paraqet diskriminim gjinor nëse shpallja inkurajon gjininë më pak të përfaqësuar të aplikojnë me qëllim të promovimit të barazisë gjinore;

1.5. që të mos disfavorizojë një punëkërkes, duke vendosur rregulla, kritere ose metoda procedurale, që në dukje janë neutrale, por që në praktikë janë më pak të favorshme për personat e një gjinie, që përmban diskriminim të tërthortë gjinor;

1.6. të punësojë personin pa dallim gjinor, në çdo pozitë ose vend të lirë, në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale;

1.7. të promovojë shpërndarje të barabartë, ndërmjet meshkujve dhe femrave në lloje të ndryshme të vendeve të punës dhe brenda kategorive të ndryshme të punonjësve, përmes trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale si dhe masave të tjera të përkohshme;

1.8. të sigurojë që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera;

1.9. të zbatojë kritere të barabarta në vlerësimin e cilësisë së punës;

1.10. Punëdhënësi nuk mund të zbatojë një kriter vlerësues, në dukje neutral, por që në praktikë është në disavantazh të personave të gjinisë tjetër;

1.11. Në veçanti, kur sistemi i klasifikimit të vendeve të punës përdoret për të përcaktuar pagën, bazohet në kriteret e njëjta për meshkujt dhe femrat dhe shmangë diskriminimin në bazë të gjinisë;

1.12. të japë pagë të barabartë për punë të barabartë dhe punë me vlerë të barabartë;

1.13. Punëdhënësi është i obliguar që të sigurojë një mjedis të tillë të punës në të cilin asnjë nga punëtorët nuk është subjekt i trajtimit të padëshirueshëm të natyrës seksuale nga punëdhënësi, mbikëqyrësi, apo kolegët, duke përfshirë trajtimin e padëshiruar fizik, verbal ose joverbal

Ligjet

LBGJ

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -
020 -2015

Nenet

Neni 19

Ndalimi i diskriminimit gjinor në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime

1. Ndalohet Diskriminimi në bazë të gjinisë në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime
2. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat të cilët ofrojnë mallra dhe shërbime, të cilët janë në dispozicion për publikun pavarësisht nëse personi në fjalë i përket sektorit publik apo privat, duke përfshirë dhe organet publike, të cilat janë ofruar jashtë zonës së jetës private dhe familjare të ofruara nga institucionet publike dhe private.
3. Ky ligj nuk cenon lirinë e individit për të zgjedhur një partner kontraktual për sa kohë që zgjedhja e një individi e partnerit kontraktual nuk është bazuar në gjininë e atij personi.
4. Ky ligj nuk do të përjashtojë diferencat në trajtim, nëse sigurimi i mallrave dhe shërbimeve ekskluzivisht ose kryesisht për anëtarët e një gjinie justifikohet me një qëllim legjitim dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë adekuate dhe të nevojshme.

Neni 20

Ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë

1. Ndalohet diskriminimi mbi bazë gjinore në institucione arsimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen në arsimim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, mjete dhe përfitime si bursat, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe titujve shkencor, qasjen në trajnime profesionale, ndjekjen e arsimimit, sporteve dhe fushave tjera.

LBGJ

Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L -
020 -2015

2. Veprimet në vijim përbëjnë diskriminim në bazë gjinore dhe janë të ndaluara:

2.1. çdo kufizim apo pengesë me bazë gjinore, në krijimin e mundësive të nevojshme, për t'u shkolluar në institucione publike e private, të cilat ofrojnë shkollim apo kualifikime tjera dhe shërbime trajnimi;

2.2. Ofrimin e mundësive të ndryshme për meshkujt dhe femrat në zgjedhjen e fushës së veçantë të studimit, trajnim apo diplomim, dhe në lidhje me kohëzgjatjen e klasave, përveçse kjo për ligjet nga një qëllim i ligjshëm dhe mjetet për arritjen e atij qëllimi janë ato që duhen dhe të nevojshme.

Ligjet

LT

Ligji për trashëgiminë Nr. 2004/26 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/26 Trashëgiminë në Kosovë Nr. 06/L-008 - 2018

KPPK

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës Nr. 04/L-123 - 2012

LESP

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale NR. 04/L-149 dhe Ligji Nr. 05/L -129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale i Kosovës.

Nenet

Neni 3

Barazia në trashëgimi

3.1. Të gjithë personat fizikë në kushte të njehta janë të barabartë në trashëgimi.

3.2. Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia është njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës apo të organit kompetent si dhe fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim.

3.3. I adoptuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë.

3.4. Të huajt janë të barabartë në trashëgimi me kosovarët, me kusht reciprociteti. Reciprociteti prezumohet.

Neni 5

1. Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme.

2. Gjykata detyrohet të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë.

3. Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.

4. Kushdo që është privuar nga liria me arrest menjëherë njoftohet në gjuhën që e kupton për arsyet e heqjes së lirisë. Kushdo që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës sillet para gjyqtarit të gjykatës themelore në juridiksionin e arrestimit brenda dyzet e tetë (48) orëve. Gjyqtari vendos për caktimin e paraburgimit, në pajtim me Kapitullin X të këtij Kodi

Neni 5.1

1. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit, apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues.

Ligjet

LESP

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale NR. 04/L-149 dhe Ligji Nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale i Kosovës.

LAPURK

Ligji për Arësimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032

LALRK

Ligji për Arësimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037

LALRK

Ligji për Arësimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037

LALRK

Ligji për Arësimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037

LALRK

Ligji për Arësimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037

Nenet

Neni 5.2

2. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrë plotësisht të paanshme. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal në Republikën e Kosovës.

Neni 3.6

Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim në baza ekzistuese ose të supozuara, siç është ai: gjinor, racor, i orientimit seksual, i paaftësitë fizike, intelektuale ose i çfarëdo paaftësie tjetër, i gjendjes martesore, i ngjyrës, i fesë, i opinioneve politike apo të tjera, i përkatësisë kombëtare, etnike ose shoqërore, i shoqërimit me ndonjë komunitet, i pronës, i lindjes ose i ndonjë gjendje tjetër të nxënësit apo familjes së tij.

Neni 5.1

Qasja në arsimin e lartë

1. Në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi.

Neni 31.4.1

Mbrojnë studentët nga çdo lloj diskriminimi.

Neni 6.1.7

Promovimin e mundësive të barabarta në qasjen dhe pranimin në arsimin e lartë, në zhvillimin dhe trajnimin e personelit, në mundësitë për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit të lartë.

Neni 5,2

2. Nuk do të ketë kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë.

Ligjet

LLAOJQ

Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare Nr. 06/L-043

LLAOJQ

Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare Nr. 06/L-043

LLAOJQ

Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare Nr. 06/L-043

LLAOJQ

Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare Nr. 06/L-043

LPZH

Ligji për Persona të zhdukur Nr. 04/L-023

LMS

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve Nr. 06/L -085

Nenet

Neni 4.5

Asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociuar apo për të mos u asociuar.

Neni 5. 3.

Politikat, legjislacioni, si dhe aktivitetet lidhur me OJQ-në, zbatohen në përputhje me bazat e përcaktuara me Ligjin përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 14.2

Kufizimet dhe ndalimet në ushtrimin e lirisë së asociimit bëhen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente, vetëm për organizatat ose aktivitetet që cenojnë rendin kushtetues, shkelin lirinë dhe të drejtat e njeriut, nxisin urrejtje racore, kombëtare, etnike a fetare.

Neni 5.1

Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo person ushtron lirinë e asociimit në mënyrë të barabartë.

Neni 3

Ndalimi i diskriminimit

Personat e zhdukur dhe familjarët e tyre gëzojnë të drejta të barabarta dhe përjashtohen nga çdo formë e diskriminimit në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal

Neni 5.1.7

Një veprim apo mosveprim nga ose në emër të një institucioni publik është diskriminues, shtypës, kryhet nga pakujdesia ose përbën keqmenaxhim të rëndë;

Ligjet

LPV

Ligji për persona të verbër Nr.
04/L – 092

LPK

Ligji për Policinë Nr. 04/L-076

LFK

Ligji për familjen i Kosovës Nr.
2004/32

LEP

Ligji mbi edukimin parashkollor
Nr. 02/L-52

LARPPPAK

Ligji për aftësimin, riaftësimin
profesional dhe punësimin e
personave me aftësi të kufizuara
Nr. 03/L-019

Nenet

Neni 4.1

1. Personat e verbër mbrohen nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes talljes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Neni 2.1

Parimet udhëzuese

1. Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

1.1. trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;

Neni 4.

1. Të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me këtë Ligj. Nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave në bazë të gjinisë, moshës, gjendje martesore, gjuhës, paaftësisë mendore apo fizike, orientimit seksual, përkatësisë apo bindjeve politike, prejardhjes etnike, kombësisë, religjionit apo besimit, racës, prejardhjes shoqërore, pasurisë, lindjes apo gjendjes tjetër.

Neni 4

Edukimi në institucionet parashkollore do të bazohet në këto parime:

(a) Barazia;

(b) Gjithë përfshirja;

(f) Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve;

Neni 5.1

1. Diskriminimi përfshin çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjuhës ose anëtarësisë sindikale, i cili konsiston në mosdhënie të mundësive të barabarta ose trajtimin jo të barabartë në punësim apo në profesion.

Ligjet

LARPPPAK

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
Nr. 03/L-019

LARPPPAK

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
Nr. 03/L-019

LBJNÇP

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar Në Çështjet Penale
Nr. 04/L-213

LPPA

Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

LSDPPT

Ligji Nr. 05/L -067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

Nenet

Article 5.2

2. Çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune në bazë të aftësive të caktuara që kërkohen për atë vend pune, nuk konsiderohet si diskriminim.

Article 5.3

3. Ndalohet çdo lloj diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar ju garantohet mbrojtje ligjore e barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi në të gjitha situatat.

Neni 17.1

Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut

1. Ekstradimi i një personi të kërkuar nuk lejohet nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkesa është bërë për qëllime të ndjekjes penale ose të ndëshkimit për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, anëtarësisë së tij apo saj në ndonjë grup shoqëror, apo nëse pozita e tij apo saj në shoqëri mund të paragjykohet për njërin nga këto arsye.

Neni 6

Neni 6 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit 1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. 2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse. 3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit.

Neni 4

Mbrojtja Përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit, fyerjes dhe gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të njohura nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë me standardet dhe parimet e përcaktuara me Konventën Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.

Ligjet

LSHCRK
LIGJI Nr. 03/L-149 PËR
SHËRBIMIN CIVIL TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

LSHCRK
LIGJI Nr. 03/L-149 PËR
SHËRBIMIN CIVIL TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

LSHCRK
LIGJI Nr. 03/L-149 PËR
SHËRBIMIN CIVIL TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

LQDP
LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE
NË DOKUMENTE PUBLIKE

LLF
Ligji Nr. 02/L-31 PËR LIRINË
FETARE NË KOSOVË

Nenet

Neni 5.1.2

Jodiskriminimi - Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Neni 11.1

Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.

Neni 5.1.9.

Parimi i mundësive të barabarta për komunitete dhe gjini – Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Mundësi të barabarta për pjesëmarrje në shërbimin civil në organet e administratës publike kanë pjesëtarët e dy gjinive.

Neni 1

Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.

Neni 2

Mbrojtja nga Diskriminimi

2.1. Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar ose i privilegjuar në çfarëdo mënyre në bazë të besimit fetarë, përkatësisë ose jopërkatësisë së një Bashkësie fetare, ose për kryerjen e ceremonive dhe ritualeve fetare.

2.2 Askush nuk duhet të pengohet ose të detyrohet të marrë pjesë në ceremonitë fetare, ose në forma të tjera të manifestimit të besimit fetar.

Ligjet

LLF
Ligji Nr. 02/L-31 PËR LIRINË
FETARE NË KOSOVË

LASH
Ligji Nr. 04/L-088 PËR
ARKIVAT SHTETËRORE

LSHM
LIGJI PËR SHËNDETIN
MENDOR Nr. 05/L -025

LSHP
LIGJI NR. 06/L-038 PËR
SHËRBIMET POSTARE

LKE
LIGJI Nr. 04/L-109 PËR
KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE

Nenet

Neni 3

Barazia Fetare

Të gjithë personat, pavarësisht nga besimi ose bindja e tyre, pavarësisht nga përkatësia në ndonjë bashkësi fetare ose pjesëmarrja në ndonjë ceremoni fetare janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejta të njejta në jetën civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Të gjithë personat juridik dhe fizik gëzojnë mbrojtje të njejtë para ligjit.

Neni 12. 2.

Neni 12 Shfrytëzimi i materialit arkivor

2. Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës në materialin e arkivuar në Agjenci, me përjashtim të kufizimeve të cilat parashihen me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 8

Neni 8 Mbrojtja nga diskriminimi dhe trajtimet çnjerëzore

1. Personave me çrregullime mendore u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe dispozitave ligjore në fuqi.
2. Ndalohet çfarëdo shkelje, nënçmimi, torture, dënimi apo trajtimi çnjerëzor ndaj personit me çrregullime mendore.

Neni 4.1

1. Ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve postare bëhet në tërë territorin e Republikës së Kosovës nga personat fizik dhe juridikë mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë, mos diskriminimit, objektivitetit dhe transparencës.

Neni 3.1

1. Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike duhet të bazohet në parimet e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të burimeve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kriterëve, kushteve dhe procedurave rregullatore, **transparencë dhe mosdiskriminim.**

decisionTitle***decisionDescription***

(ECtHR, Opuz v. Turkey (No. 33401/02), 9 June 2009)

Opuz kundër Turqisë (Opuz v. Turkey), GJEDNJ-ja bëri një konstatim të një **diskriminimi të tërthortë për shkak të gjinisë**, së bashku me të drejtën e jetës dhe mospësimin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës sepse policia dhe gjyqësori kishin dështuar në zbatimin e përshtatshëm të ligjit që lidhej me dhunën në familje.

[https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22itemid%22:\[%22003-2659720-2907427%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng-press#{%22itemid%22:[%22003-2659720-2907427%22]})

Turan Cakir kundër Belgjikës (Numrat 44256/06), 10 Mars 2009

Në çështjen Turan Cakir kundër Belgjikës (Turan Cakir v. Belgium), kërkuesi u ankua për brutalitet nga ana e policisë gjatë arrestimit të tij/saj, me shkaktimin e lëndimeve të ashpra, shoqëruar me kërcënime dhe fyerje raciste. GJEDNJ-ja **konstatoi se dhuna e shkaktuar shkelte të drejtën e kërkuesit për të mos pasur trajtim poshtëruës dhe çnjerëzor** (sipas Nenit 3 të KEDNJ-së). Ajo konstatoi gjithashtu se moshetimi i duhur nga ana e shtetit i ankimeve për keqtrajtim të kërkuesit shkelte detyrimet procedurale të shtetit sipas po të njëjtit nen. Krahas kësaj, ajo konstatoi se moshetimi gjithashtu përbënte shkelje të Nenit 3 së bashku me të drejtën për të mos u diskriminuar.

Gaygusuz kundër Austrisë (Nr. 17371/90), 16 Shtator 1996 (ECtHR, Gaygusuz v. Austria (No. 17371/90), 16 September 1996)

Në çështjen Alujer Fernandez dhe Caballero García kundër Spanjës (Alujer Fernandez and Caballero García v. Spain) kërkuesit u ankuan se, ndryshe nga Katolikët, ata nuk ishin në gjendje të caktonin një pjesë të tatimit të tyre mbi të ardhurat direkt për kishën e tyre. **GJEDNJ-ja konstatoi se çështja ishte e papranueshme** sipas fakteve sepse kisha e kërkuesit nuk ishte në një pozitë të krahasueshme me Kishën Katolike sepse ata nuk ia kishin bërë këtë kërkesë qeverisë dhe sepse qeveria kishte një marrëveshje reciproke në fuqi me Vatikanin.

WELLER v. HUNGARY (Application no. 44399/05) 31/03/2009

Në çështjen Weller vs Hyngary, një grua Rumune u martua me një Hungarez, dhe të dy bashkëshortët patën katër fëmijë. Ajo nuk ishte e përshtatshme që të kërkonte shpërblimin e lindjes të pagueshëm pas lindjes së fëmijës, sepse ajo nuk ishte shtetase Hungareze. Bashkëshorti i saj u përpoq të merrte shpërblimin por u refuzua nga qeveria, e cila tha se shpërblimi paguhej vetëm për nënat. **GJEDNJ-ja vendosi se ajo ishte diskriminuar për shkak të atësisë** (dhe jo gjinisë), sepse prindërit meshkuj birësues ose kujdestarët meshkuj kishin të drejtë të pretendonin shpërblimin, ndërsa baballarët natyralë nuk kishin të drejtë. **Prandaj ka shkelje të nenit 14 të Konventes në lidhje me nenin 8 të konventës.**

decisionTitle***decisionDescription***

D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007

Në çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (D.H. and others v. the Czech Republic), u përdorën një seri testesh për të përcaktuar inteligjencën dhe përshtatshmërinë e studentëve me synimin për të përcaktuar nëse ata duhet të zhvendoseshin nga institucionet e zakonshme arsimore dhe të kalonin në shkolla të posaçme. Këto shkolla të posaçme ishin ngritur për studentët me aftësi të kufizuar inteligjence dhe burime të tjera me vështirësi për të mësuar. I njëjti test u zbatua për të gjithë studentët që shqyrtoheshin për t'u zhvendosur në shkolla të posaçme. Megjithatë, në praktikë testimi ishte krijuar për popullsinë e zakonshme Çeke me pasojën se studentët Rom kishte më shumë të ngjarë të dilnin keq – gjë e cila ashtu ndodhi, me pasojën se nga 50 deri 90 për qind e fëmijëve Rom u arsimuan jashtë sistemit kryesor shkollor. **GJEDNJ-ja vendosi se ky ishte një rast i diskriminimit të tërthortë. Prandaj ka shkelje të nenit 14 të Konventes.**

FABRIS v. FRANCE (Application no. 16574/08) 7 February 2013

FABRIS v. FRANCE (Application no. 16574/08) 7 February 2013

Aplikanti u ankua se, si një fëmijë "i lindur nga shkelja kurorës", ai ishte të paaftë për të mbrojtur të drejtat e trashëgimisë së tij dhe që të tilla të pajustificuara diskriminimi vazhdoi pas vendimit të Gjykatës në Mazurek dhe pavarësisht nga miratimi i ligjit të vitit 2001. Ai pretendoi se kishte pasur një shkelje të nenit 14 të Konventës së marrë në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1

Gjykata konstatoj se ka shkelje te nenit 14 te Konventes ne lidhje me nenin 1 te Protokolit 1

VALLIANATOS AND OTHERS v. GREECE (Applications nos. 29381/09 and 32684/09) 7 November 2013

Ankuesit pretenduan se fakti që sindikatat civile paraqiten me Ligjin nr. 3719/2008 u hartuan vetëm për çiftet e përbërë nga të rritur të ndryshëm të seksit që shkelin të drejtën e tyre për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare dhe përbënin një diskriminim të pajustificuar midis çifteve të gjinisë së ndryshme dhe të gjinisë së njëjtë, në dëm të këtij të fundit. Ata u mbështetën në nenin 14 të Konventës së marrë në lidhje me nenin 8

Gjykata ka vendos se ka pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës;